

Njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol SHPKNJP Radovish do t'i bashkohet Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish.

(lënda nr. 08-47/2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 08.03.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim përqendrim ndërmjet Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Buchim SHPKNJP Radovish, me seli në rr. Marshal Tito pn, Radovish, dhe Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol SHPKNJP Radovish, me seli në rr. Sveti spaso radovishki nr.1, Radovish, e cila do të formohet nga bashkimi i Borov dol Radovish SHPKNJP me Buchim Radovish SHPKNJP.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Buçim SHPKNJP Radovish, është një shoqëri, aktiviteti primar i së cilës është nxjerrja e xeheve të tjera të metaleve me ngjyra. Buçim SHPKNJP Radovish, deri në vitin 2021, merrej me mihje të lëndëve të para minerale të bakrit dhe arit. Megjithatë, që nga viti 2021, nxjerrja e lëndës së parë minerale në minierë është pezulluar për shkak të varfërimit të xehes në gropa të hapura. Pra, nga viti 2021 Buçim SHPKNJP Radovish do të fillojë me përpunimin e xehes së nxjerrë nga miniera e Borovit në një fabrikë industriale – flotacion.

Borov dol SHPKNJP Radovish është një shoqëri, aktiviteti primar i së cilës është edhe nxjerrja e xeheve të tjera të metaleve me ngjyra. Borov dol Radovish ShPKNJP është themeluar në vitin 2010, me qëllim të kryerjes së hulumtimeve të detajuara gjeologjike për praninë e xehes së bakrit në lokacionin Borov dol, në Komunën e Konçes, Komunën e Shtipit dhe Komunën e Radovishit.

Buçim SHPKNJP Radovish dhe Borov dol SHPKNJP Radovish janë të pranishme në tregun në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke pasur parasysh se veprimtaria e tyre është e bazuar në këtë territor, sipas të drejtave koncesionare që kanë pjesëmarrësit për kryerjen e veprimtarisë së tyre, si dhe licencave dhe lejeve të nevojshme.

Pjesëmarrësit nuk kryejnë shitje me pakicë dhe nuk kryejnë shitje të produkteve finale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Buçim SHPKNJP Radovish dhe Borov dol SHPKNJP Radovish nuk kanë asnjë pjesëmarrje apo pjesë pronësore në asnjë shoqëri tjetër të themeluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu relevant është tregu i industrisë minerare me bakër, gjegjësisht produkte burse me veti bakri (bakër katodik, koncentrat bakri)

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në

adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

16.03. 2023

Shkup